



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.12.2020

Për mbledhjen Nr. 52, datë 21.12.2020, ora 10:30
Të Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e hënë, datë 21.12.2020, ora 10:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 52 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1- Mbi kërkesën e shoqërisë “Wenerg” sh.a., për marrjen e autorizimit të ERE-s për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë në favor të bankës OTP Albania sh.a. (ish-Societe Generale Albania sh.a.)
- 2- Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a. për barrësim të aseteve (makineri dhe pajisje) në favor të “OTP Albania” sh.a, për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të Hec-it “Dardha 1”
- 3- Mbi licencimin e shoqërisë “Erdy Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kalis” me kapacitet të instaluar 2138 kW
- 4- Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Xhuxhë 1” me kapacitet të instaluar 3487 kW dhe Hec “Xhuxhë 2” me kapacitet te instaluar 1254 kW dhe me kapacitet total te instaluar 4741 kW
- 5- Mbi licencimin e shoqërisë “Hec Zall Xhuxhë” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
- 6- Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ES 2019” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
- 7- Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. për vendosje hipoteke dhe barre siguroese/peng në favor të bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do krijohen nga shoqëria koncesionare "Seka Hydropower" sh.p.k
- 8- Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. për licencim në

veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike

9- Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Energy Supply - Al” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 310, seria F11/FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, si dhe licencës nr. 309, seria T11/T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

10- Mbi kërkesën e shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 13, datë 28.01.2008, i ndryshuar

11- Mbi kërkesën e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 89, datë 06.08.2008, i ndryshuar

12- Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 06.08.2008, i ndryshuar

13- Mbi kërkesën e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 63, datë 13.06.2008, i ndryshuar

14- Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento S.R.L. Albania” sh.p.k. për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar

15- Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar

16- Mbi shqyrtimin e propozimit të OST sh.a. për treguesit e kritereve standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit së energjisë elektrike për vitin 2021

17- Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)

18- Mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a.

19- Mbi korrigjimin e pagesave rregullatore për vitin 2020, për disa nga të licencuarit në sektorin e energjisë

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI